

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT “MBI SEKTORIN E KONDICIONIMIT TË AUTOMJETEVE (MAC) NË SHQIPËRI”

Autor: Arjan Kullolli

Data: Nëntor 2025

QËLLIMI

Ky studim analizon zhvillimin e sektorit të kondicionimit të automjeteve (Mobile Air Conditioning – MAC) në Shqipëri gjatë periudhës 2019–2025, me fokus në strukturën e flotës së automjeteve, përdorimin e gazeve ftohëse, ndikimin klimatik të sektorit dhe sfidat që lidhen me zbatimin e Amendamentit të Kigalit dhe politikave evropiane për reduktimin e gazeve Të fluruara.

GJETJET KRYESORE

1. Rritje e ndjeshme e flotës së automjeteve

Flota kombëtare e automjeteve është rritur nga rreth 578 mijë mjete në vitin 2019 në mbi 917 mijë mjete në mesin e vitit 2025. Makinat dhe furgonët e vegjël përbëjnë rreth 88% të totalit dhe janë konsumatorët kryesorë të refrigerantëve në sektorin MAC.

2. Flota vazhdon të dominohet nga automjetet e vjetra

Pavarësisht hyrjes graduale të automjeteve më moderne, rreth gjysma e flotës kombëtare vazhdon të përbëhet nga mjete të prodhuara para vitit 2005. Kjo situatë mban të lartë varësinë nga refrigeranti R134a dhe rrit rrezikun e rrjedhjeve dhe emetimeve të gazeve serrë.

3. Gazi ftohës R134a mbetet dominues

Në vitin 2025, R134a përfaqëson ende rreth 85% të tregut të refrigerantëve në sektorin MAC, ndërsa R1234yf ka arritur rreth 15%. Përdorimi i sistemeve me CO₂ (R744) mbetet pothuajse inekzistent.

4. Tranzicion gradual drejt gazeve ftohës me GWP të ulët

Numri i automjeteve që përdorin R1234yf është rritur ndjeshëm në të gjitha kategoritë, veçanërisht te automjetet e pasagjerëve, autobusët dhe makineritë bujqësore. Kjo tregon se automjetet e reja të importuara po harmonizohen gradualisht me standardet evropiane dhe kërkesat e Amendamentit të Kigalit.

5. Emetimet mbeten të larta

Emetimet e vlerësuara të sektorit MAC u rritën nga rreth 122 mijë ton CO₂ ekuivalent në vitin 2019 në mbi 150 mijë ton CO₂ ekuivalent në vitet 2023–2024. Makinat dhe furgonët kontribuojnë me mbi 70% të totalit të emetimeve të sektorit.

SFIDAT KRYESORE

Studimi identifikon një sërë problematikash që ngadalësojnë tranzicionin drejt teknologjive me ndikim më të ulët klimatik:

- Vazhdimi i përdorimit të R134a në automjete që janë projektuar për R1234yf.
- Mungesa e sistemeve të zhvilluara për rikuperimin, riciklimin dhe rigjenerimin e refrigerantëve.
- Kapacitete të kufizuara teknike dhe infrastrukturore për menaxhimin e refrigerantëve.
- Mungesa e programeve të detyrueshme të certifikimit për teknikët e sektorit MAC.
- Nivel i pamjaftueshëm monitorimi, kontrolli dhe zbatimi të kërkesave ligjore.
- Ndërgjegjësim i kufizuar i teknikëve dhe përdoruesve mbi përdorimin korrekt të refrigerantëve me GWP të ulët.

PRIORITETET E REKOMANDUARA

Afatshkurtër

- Forcimi i sistemeve të rikuperimit dhe riciklimit të R134a.
- Trajnimi dhe certifikimi i teknikëve të sektorit MAC.
- Përmirësimi i kontrollit të tregut dhe praktikave të servisimit.

Afatmesëm

- Përshpejtimi i rinovimit të flotës së automjeteve.
- Kufizimi i importit të automjeteve shumë të vjetra.
- Mbështetja e përdorimit të refrigerantëve me GWP të ulët dhe ngritja e sistemeve të grumbullimit të refrigerantëve në fund të jetës së tyre.

Afatgjatë

- Kalimi gradual i plotë drejt refrigerantëve me ndikim të ulët klimatik.
- Integrimi i menaxhimit të sektorit MAC në politikat kombëtare të klimës, energjisë dhe transportit.

PËRFUNDIM

Sektori i kondicionimit të automjeteve në Shqipëri ndodhet në një fazë tranzicioni. Nga njëra anë, flota e vjetër vazhdon të mbajë të lartë përdorimin e R134a dhe emetimet e lidhura me të; nga ana tjetër, rritja e shpejtë e automjeteve që përdorin R1234yf tregon se po krijohen kushtet për një transformim gradual drejt teknologjive më miqësore me klimën. Përshpejtimi i këtij tranzicioni kërkon ndërhyrje të koordinuara në politikat e importit, forcimin e kapaciteteve teknike, certifikimin e teknikëve dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të refrigerantëve.